**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LUSHNJE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL**
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**Nr.550 Prot.** **Lushnje, më14/01/2026**

# R E L A C I O N

## KËSHILLIT BASHKIAK

## " PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT PËR SISTEMIMIN E DY SHESHEVE TË PALLATEVE PËRGJATË RRUGËS "BESIM NURI" NË LAGJEN KONGRESI I LUSHNJES

*Të nderuar këshilltar*!

Bashkia Lushnje është përfituese e fondit nga " Granti i bazuar në performancën e bashkive për vitin 2025" , I cili do të përdoret për financimin e projektit me objekt: **Sistemimi i dy shesheve të pallateve përgjate rrugës Besim Nuri" në lagjen Kongresi i Lushnjes me vlerë 6 833 734.37 lekë me tvsh.** Mbështetur në problematikën e gjëndjes ekzistuese dhe nga kërkesat e shtuara të banoreve të zonën konform planit të zhvillimit të qytetit dhe rivlerësimit që kërkon, hapësira ku do të zhvillohet ky sistemim, u hartua projekti ku jan marë parasysh të gjitha problematikat e zonës të cila jan trajtuar konfort kushteve teknike.

Zhvillimi i këtij projekti ka për qëllim dhe objektiv:

- Sistemim i trotuarëve për kalimin e këmbësorëve.
- Disiplinimi i ujërave të shiut dhe grumbullimi i tyre deri në një pikë shkarkimi përgjatë rrugës.
- Shtrimi i koridorit të kalimit në hyrjet e godinave.
- Ndricimi i sheshit që mer pjesë në zhvillim.
- Krijimi i një hapësire të gjelbërt rekreative, shplodhëse .
- Krijimi i një këndi lojërash për fëmijë.
- Ndërtimin e mureve mbajtës për sistemimin e dherave.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !

**KRYETARI I BASHKISË**
**ERISELDA SEFA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA LUSHNJE**

Nr 550/1 Prot. Lushnje, më 14/01/2026

**PROJEKT- VENDIM**

**NR. 15 DATË 14/01/2026**

**"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT PËR SISTEMIMIN E DY SHESHEVE TË PALLATEVE PËRGJATË RRUGËS "BESIM NURI " NË LAGJEN KONGRESI I LUSHNJES.**

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë , në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja "b", pika 1.6 shkronja "a", neni 23 pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.Neni 1 shkronja "b" neni 4 pika 1 neni 12 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i përditësuar Ju:

**PROPOZOJMË**

1. Miratimin e investimit për sistemimin e dy shesheve të pallateve përgjatë rrugës "Besim Nuri " në lagjen Kongresi i Lushnjes.
2. Vlerën e investimit në shumën 6883734.37 (gjashtë milion e tetëqind e tridhjete e tre mijë e shtëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) lek me tvsh.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Drejtoria e Finacës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT

Ariola Beqo

**KRYETARI I BASHKISË**

**Eriselda Sefa**

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com